

RREGULLORE E BRENDËSHME**PEZULLIMI, TËRHEQJA/RIDHËNJA E CERTIFIKIMIT DHE
REDUKTIMI/ZGJERIMI I FUSHËS SË APLIKIMIT
KODI: FISA-RR-111**

TABELA E RISHIKIMEVE					
Nr.	Data e lëshimit	Përshkrimi	Hartoi Kons/DT	Kontrollo i Men.cil	Miratoi Admin
1	15.08.2023	Botimi i parë	M.Cukall a	Dhurata Lohja	Migena Buzra

PASQYRË E PËRMBAJTJES

1. Qëllimi
2. Fusha e zbatimit
3. Referencat
4. Përkufizime dhe shkurtime
5. Përgjegjësit
6. Përshkrime
 - 6.1. Pezullimi i certifikimit
 - 6.1.1. Pezullim i kërkuar nga shoqëria kliente
 - 6.1.2. Pezullim i kërkuar nga FISA
 - 6.1.3. Kriteret për pezullimin e certifikimit
 - 6.2. Heqja e pezullimit
 - 6.3. Tërheqja e certifikimit
 - 6.3.1. Tërheqja e certifikimit e kërkuar nga shoqëria kliente
 - 6.3.2. Tërheqja e certifikimit e kërkuar nga FISA
 - 6.3.3. Kriteret për tërheqjen e certifikimit
 - 6.4. Zgjerimi i certifikimit
 - 6.5. Reduktimi i fushës së aplikimit të certifikimit
 - 6.5.1. Reduktimi i fushës së aplikimit të certifikimit i kërkuar nga shoqëria kliente
 - 6.5.2. Reduktimi i fushës së aplikimit të certifikimit i kërkuar nga FISA
 - 6.5.3. Kriteret për reduktimin e fushës së certifikimit

1. QELLIMI

Kjo Rregullore specifikon në detaje kushtet e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të certifikimit dhe veprimet që duhet merren në raste të tilla.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo rregullore zbatohet nga FISA në të gjitha rastet plotësohen kriteret për pezullimin, tërheqjen ose ridhënjën e certifikimit, reduktimit dhe zgjerimit të statusit "I certifikuar" për shoqëritë kliente kur kërkohet nga FISA, apo me kërkesë të vetë Shoqërisë kliente.

3. REFERENCAT

ISO/IEC 17021-1:2015 *Vlerësimi i Konformitetit- Kërkesat për trupat që kryejnë auditimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit*

ISO/IEC 17000 *Vlerësimi i Konformitetit. Fjalori dhe Parimet e Përgjithshme.*

4. PËRKUFIZIME DHE SHKURTIME

4.1 Në këtë dokument janë përdorur terma dhe përkufizime të dhëna në standardin ISO 17000 "Vlerësimi i Konformitetit. Fjalori dhe Parimet e Përgjithshme dhe ISO/IEC 17021:2015

4.2 Shkurtime të përdorura:

FISA:	organizmi certifikues FISA shpk
SM:	Sistemi i Menaxhimit
AD:	Administratori i "FISA" shpk
MC:	Menaxheri i cilësisë
TC:	Njësia certifikuese e FISA shpk
TCSM	Trup certifikuese e sistemeve të menaxhimit
SC:	Skemë certifikimi
SMC:	Sistemi i menaxhimit të cilësisë
SMSI:	Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit
SMTI:	Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit

5. PËRGJEGJËSITË

Administratori është përgjegjës për të siguruar zbatimin me korektësi të kësaj rregulloreje .

Përgjegjësi i TC, përgjegjësit e skemave të certifikimit dhe personeli i përfshirë në certifikim kanë përgjegjësinë për të zbatuar kërkesat e kësaj procedure në funksionet e tyre.

6. PERSHKRIMI

6.1 Pezullimi i Certifikimit

Pezullimi i certifikimit nënkupton vendosjen nga FISA të kufizimit të përkohshëm të statusit të certifikimit të sistemit të menaxhimit të klientit, për skemën përkatëse të certifikimit, për një pjesë ose të gjithë fushën e aplikimit të certifikimit. Statusi i certifikimit mund të pezullohet me kërkesë vullnetare nga Shoqëria kliente e certifikuar ose në bazë të kërkesës së FISA, kur plotësohen një apo disa nga kushtet e përcaktuara në pikën 6.1.3. Pezullimi i certifikimit mund të vendoset vetëm për një pjesë të fushës së certifikimit kur kushtet e pikës 6.1.3 të kësaj rregulloreje plotësohen për një pjesë të fushës së aplikimit të certifikimit. Në të dyja rastet, si për pezullimin vullnetar apo pezullimin e kërkuar nga FISA, zbatohet e njëjta procedurë.

6.1.1 Pezullim i kërkuar nga Shoqëria kliente

Shoqëria kliente e certifikuar i paraqet FISA-s një kërkesë me shkrim për pezullimin e certifikimit. Vendimin për pezullim e merr Administratori brenda 10 ditëve nga bërja e kërkesës me shkrim. Periudha për vetë-pezullimin nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj. Pas kësaj, certifikimi tërhiqet, nëse nuk ka ndonjë kërkesë tjetër nga shoqëria kliente.

Në faqen e internetit të FISA-s, në krah të emrit të shoqërisë, shënohet statusi “i pezulluar”.

6.1.2 Pezullim i kërkuar nga FISA

Kur plotësohen një ose disa nga kushtet për pezullim të certifikimit, të renditura në pikën 6.1.3 të kësaj rregulloreje, mbështetur në evidencat e grumbulluara, Komiteti i certifikimit i FISA, pas verifikimit të informacionit dhe shqyrtimit të të dhënave, merr vendimin për pezullim të certifikimit. Administratori i dërgon shoqërisë kliente vendimin për pezullim, duke dhënë një shpjegim të qartë të arsyeve të pezullimit.

Shoqëria kliente ka të drejtë të apelojë brenda 10 ditëve pas marrjes së vendimit. Ankesa trajtohet konform procedurës së “Trajtimit të ankesave dhe apelimeve”. Megjithatë, nisja e një ankimi nuk çon në pezullimin e vendimit të FISA mbi certifikimin.

Pavarësisht marrjes së vendimit për pezullim, Shoqëria kliente ka detyrimin që të paguajë tarfiën e procedurës së vlerësimit, sipas marrëveshjes kontraktuale

Fisa publikon pezullimin e certifikimit në faqen e saj të internetit, duke shënuar “pezulluar” në krah të emrit të shoqërisë.

6.1.3 Kriteret për pezullimin e certifikimit

Kriteret mbi bazën e të cilave FISA vendos për pezullimin e certifikimit janë:

- Konstatohen shkelje të rregullores së përdorimit të logos dhe certifikatës nga shoqëria kliente e certifikuar, duke keqpërdorur simbolin e certifikimit dhe/ose certifikatën, por natyra dhe rreziku i gjetjeve të tilla nuk e justifikojnë tërheqjen e certifikimit.
- Mos respektimi i afateve të përcaktuara në procedurat e FISA-s.
- Mos zgjidhja e Jo-konformiteteve në përputhje me procedurat e FISA-s.
- Rezultati negativ i hetimit të një ankese nga një palë e tretë për shoqërinë kliente.
- Mospagimi i tarifave.
- Shoqëria kliente nuk ka njoftuar FISA-n brenda afateve të përcaktuara në marrëveshje për ndryshimet që kanë ndodhur në Shoqërinë kliente, gjë që ndikon në përmbushjen e kërkesave të certifikimit.
- Shoqëria e certifikuar nuk i siguron FISA-s akses tek personeli, dokumentacioni, vendndodhja, pajisjet, informacionet dhe regjistrimet.

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania.

tel/fax: E-mail

www.fisa.pro

- h. Shoqëria e certifikuar nuk siguron aksesin tek furnitorët e tyre, të cilët kryejnë një pjesë të proceseve/shërbimeve/operacioneve që janë objekt i certifikimit, për të vlerësuar konformitetin gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve.
- i. Mungesa e dokumentacionit të kërkuar për kryerjen e vizitave mbikëqyrëse.
- j. Shoqëria e certifikuar nuk respekton programin e certifikimit.
- k. Shoqëria e certifikuar nuk ka kryer ndonjë aktivitet brenda fushës së aplikimit të certifikimit në skemën përkatëse për më shumë se një vit.
- l. Shoqëria e certifikuar nuk pranon organizimin e vizitës mbikëqyrëse ose vizitën e jashtëzakonshme.

I gjithë personeli efektiv i FISA-s, auditorë, personeli i jashtëm i nënkontraktuar nga FISA, apo subjekte të nënkontraktuar, të cilët konstatojnë shkeljen e këtyre kritereve kanë detyrimin që t'i raportojnë menjëherë tek përgjegjësi i TC

Perioda e pezullimit të certifikimit nuk është më shumë se 6 muaj.

6.2 Heqja e pezullimit

Kur Shoqëria kliente konsideron se janë zgjidhur Jo-konformitetet që çuan në pezullimin e certifikimit, i komunikon zyrtarisht FISA-s gatishmërinë e saj për të nisur procesin e revokimit, duke kërkuar heqjen e pezullimit dhe përcjell në FISA dokumentacionin/dëshmitë e nevojshme.

FISA, pasi merr dokumentacionin/dëshmitë e dorëzuara nga shoqëria kliente kryen veprimet e mëposhtme:

- vlerësimi i dokumentacionit / regjistrimeve nga grupi i auditimit,
- organizimi i një auditimi tek klienti.

Përgjegjës për kryerjen e këtyre veprimeve është Lead-auditori, i cili vepron në përputhje me "Procedurën e certifikimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit". Vendimin përfundimtar e merr Komiteti i Certifikimit. Nëse vendimi është pozitiv, Fisa heq pezullimin dhe përditëson listën e shoqërive të certifikuara. Nëse vendimi është negativ, FISA fillon procedurën e tërheqjes së certifikimit. Në të dy rastet FISA informon Shoqërinë kliente mbi vendimin e marrë.

Nëse vendimi është negativ, Shoqëria kliente ka të drejtë të paraqesë ankesë sipas procedurës së trajtimit të ankesave dhe apeliave.

6.3 Tërheqja e certifikimit

Tërheqja e certifikimit nënkupton ndërprerjen e statusit të certifikimit për skemën e dhënë të certifikimit. Tërheqja mund të kërkohej nga shoqëria kliente e certifikuar ose nga FISA. Në të dyja rastet zbatohet e njehta procedurë.

Në rast të tërheqjes së certifikimit, shoqëria kliente mund të ri-aplikojë për certifikim vetëm pas 6 muajsh.

6.3.1 Tërheqja e certifikimit e kërkuar nga shoqëria kliente

Shoqëria kliente, e certifikuar, paraqet pranë FISA-s kërkesën me shkrim për tërheqje të certifikimit.

Vendimin për tërheqjen e merr Administratori brenda 15 ditëve nga bërja e kërkesës me shkrim. FISA informon shoqërinë kliente mbi vendimin dhe kërkon kthimin mbrapsht të certifikatës së lëshuar.

FISA përditëson listën e organeve të certifikuara në websitin e FISA-s duke e vendosur Shoqërinë kliente në listën e kompanive që ju është tërhequr statusi i certifikimit. Shoqëria kliente qëndron në këtë listë derisa ky status i certifikimit të jetë i vlefshëm.

6.3.2 Tërheqja e certifikimit e kërkuar nga FISA

Statusi i certifikimit tërhiqet nga FISA kur plotësohet një ose disa nga kriteret për tërheqje, të renditura në pikën 6.3.3 të kësaj rregulloreje. Personat përgjegjës të FISA i rekomandojnë Komitetit të certifikimit tërheqjen e certifikates, shoqëruar me të gjitha dëshmitë. Komiteti i certifikimit, merr vendimin e tij për tërheqje dhe ja përcjell Administratorit. Administratori mund të kërkojë më shumë informacion rreth këtij vendimi, por nuk mund ta ndryshojë atë. Administratori merr vendim për tërheqjen dhe njofton me shkrim shoqërinë kliente, duke dhënë një argumentim të qartë mbi shkaqet që kanë çuar në tërheqje. Në këtë rast, FISA i kërkon Shoqërisë kliente të kthejë mbrapsht certifikatën dhe programin e certifikimit.

FISA përditëson listën e organeve të certifikuara në websitin e saj, duke e vendosur Shoqërinë kliente në listën e shoqërive, të cilave ju është tërhequr statusi i certifikimit. Shoqëria kliente qëndron në këtë listë derisa ky status i certifikimit do të ishte i vlefshëm.

Shoqëria ka të drejte të apelojë brenda 10 diteve pas marrjes së njoftimit. Ankesa trajtohet konform procedurës së trajtimit të ankesave dhe apeliave. Megjithatë, nisja e një ankimi nuk çon në pezullimin e vendimit të FISA, mbi tërheqjen e certifikimit.

6.3.3 Kriteret për tërheqjen e certifikimit

Kriteret mbi të cilat FISA vendos për tërheqjen e certifikimit janë si në vijim:

- a. Shoqëria kliente ose personi juridik ka falimentuar.
- b. Shoqëria kliente nuk arrin të përmbushë kërkesat e certifikimit pas përfundimit të afatit të pezullimit
- c. Kur afati i pezullimit ka përfunduar dhe Shoqëria kliente nuk ka sjellë asnjë informacion për mbylljen e kushteve për pezullim.
- d. Ka gjetje të shkeljes së rregulloreve të detyrueshme të FISA nga ana e shoqërisë kliente të certifikuar, duke përfshirë keqpërdorimin e simbolit të certifikimit/certifikatës së certifikimit, të cilat paraqesin rrezik dhe impakt shumë të lartë.
- e. Ka dëshmi objektive të mashtrimit në aktivitetet e shoqërisë kliente
- f. Nëse shoqëria kliente me dashje keqinformon FISA-n, fsheh qëllimisht informacionin ose dorëzon shënime ose prova të rreme në FISA.
- g. Nëse shoqëria kliente bën referencë në certifikim në mënyrë të gabuar në kundësthim me Rregulloren e FISA, FISA-RR-112, për skema certifikimi apo aktivitete të tjera, për të cilat nuk është certifikuar.
- h. Ekzistenca e situatave objektive që pengojnë përmbushjen e marrëveshjes së certifikimit ndërmjet FISA dhe shoqërisë kliente (kontrata)
- i. Afati i fundit për pagesë të përcaktuar në vendimin e pezullimit ka përfunduar.
- j. Mos mbyllje e ankesave ndaj shoqërisë kliente.
- k. Nëse shoqëria kliente është e përfshirë në deklarata dhe sjellje që dëmtojnë prestigjin dhe reputacionin e certifikimit të tij ose të FISA-s.

6.4 Zgjerimi i certifikimit

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania.

tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

6.4.1 Me zgjerim të certifikimit do të kuptojmë shtrirjen e sistemit të menaxhimit të certifikuar në procese/shërbime/aktivitete/vendndodhje të tjera që nuk kanë qenë të përfshira në fushën e certifikimit të shoqërisë kliente.

Shoqëria kliente që ka statusin e certifikimit fillestar i lind e drejta të aplikojë për zgjerimin e certifikimit pasi të jetë përfunduar me sukses vizita e parë mbikqyrëse.

Shoqëria kliente e certifikuar mund të aplikojë për zgjerimin e certifikimit pasi të ketë marrë vendimin për mirëmbajtjen e certifikimit pas çdo vizitë mbikqyrëse.

Nëse shoqëria kliente e certifikuar dëshiron që FISA të menaxhojë zgjerimin e certifikimit gjatë vizitës së ardhshme të mirëmbajtjes, duhet të aplikojë për zgjerim jo më vonë se dy muaj para vizitës mbikqyrëse.

6.4.2 Në rast se shoqëria kliente e certifikuar kërkon zgjerim të fushës së aplikimit të Certifikimit, atëherë ai duhet të plotësojë formularin përkatës të aplikimit bashkë me dokumentacionin përkatës, të cilën e dorëzon në FISA.

6.4.3 Nëse shoqëria kliente kërkon të realizohet vlerësimi për zgjerim para vizitës tjetër të mbikqyrjes, FISA organizon vizitën e vlerësimit. Vlerësimi përfshin auditimin vetëm të sektorëve/procese/shërbimeve, etj., që do përfshihen në skemën e sistemit të menaxhimit të certifikuar.

Kur shoqëria kliente aplikon për zgjerim të fushës së aplikimit të certifikimit pas certifikimit fillestar, FISA rishikon programin e auditimit dhe planifikon auditimin pasues.

6.5 Reduktimi i fushës së aplikimit të certifikimit

Reduktimi i fushës së aplikimit të certifikimit do të thotë se FISA anulon një pjesë të fushës së aplikimit të certifikimit. Reduktimi i certifikimit mund të kërkohej vullnetarisht nga shoqëria kliente e certifikuar ose kërkohej nga FISA kur plotësohen një apo më shumë nga kushtet e parashtruara në pikën 6.6.3. Në të dy rastet, zbatohet e njëjta procedura.

6.5.1 Reduktimi i fushës së aplikimit të certifikimit i kërkuar nga shoqëria kliente

Reduktimi i fushës së aplikimit të Certifikimit mund të kërkohej nga shoqëria kliente si rezultat i vështirësive financiare, teknike, ose personelit. Shoqëria kliente paraqet kërkesën për reduktimin e fushës së certifikimit në FISA. Administratori merr vendimin përfundimtar për reduktimin e fushës së certifikimit të shoqërisë kliente.

FISA i lëshon shoqërisë kliente certifikatën me fushë certifikimi të reduktuar dhe e publikon fushën e reduktuar të certifikimit në faqen e internetit të FISA.

6.5.2 Reduktimi i fushës së aplikimit të certifikimit i kërkuar nga FISA

Fusha e certifikimit reduktohet nga FISA kur plotësohet një nga kushtet e reduktimit të renditura në pikën 6.6.3 të kësaj procedure. Lead-auditori, bazuar në mendimin e auditorit/ekspertit teknik, i përcjell Komitetit të certifikimit propozimin për reduktimin e fushës së certifikimit së bashku me evidencat. Komiteti i certifikimit, merr vendimin e tij për tërheqje dhe ja përcjell Administratorit. Mbi bazën e këtij vendimi, Administratori autorizon reduktimin e fushës së certifikimit të shoqërisë kliente dhe e njofton atë për vendimin e marrë, duke dhënë argumenta të qarta mbi shkaqet që kanë çuar në reduktimin e fushës së certifikimit.

FISA publikon fushën e reduktuar të certifikimit në faqen e internetit të FISA.

Shoqëria ka të drejte të apelojë brenda 10 diteve pas marrjes së njoftimit. Ankesa trajtohet konform procedurës së trajtimit të ankesave dhe apeliave. Megjithatë, nisja e një ankimi nuk çon në pezullimin e vendimit të FISA, mbi reduktimin e fushës së certifikimit.

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania.

tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

6.5.3 Kushtet për reduktimin e fushës së certifikimit

Kriteret mbi të cilat FISA vendos për reduktimin e fushës së certifikimit jepen në vijim

- a. Shoqëria kliente nuk arrin të përmbushë kërkesa për certifikim në procese/shërbime/sectorë të biznesit të tij.
- b. Jo-konformitetet që kanë të bëjnë me çështjet teknike të gjetura gjatë vizitës mbikëqyrese për të cilat shoqëria kliente nuk ka ndërmarrë veprime korrigjuese efektive.
- c. Ka ndryshime të dukshme në kushtet e veprimit të shoqërisë kliente lidhur me çështjet teknike të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në konformitetin me kërkesat e certifikimit.